



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:194100
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05626003

CAP.nr.1117/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren Halide Reka, në çështjen juridike përmbarimore të kreditores H.Sh nga Prishtina, ndaj debitorit të përmbarimit Shërbimi Spitalor, Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)- me seli në Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.879/22, të datës 07.02.2023, jashtë seance me datë 23.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit Shërbimi Spitalor, Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK), me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.879/22, të datës 07.02.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.879/22, të datës 07.02.2023 e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës, me adresë në Prishtinë, i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.154/20, i datës 06.08.2020, i lejuar nga Përmbaruesi Privat B B. T, i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori duke e atakuar të njëjtin, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktvendimin e ankimuar ta prish dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje ose të njëjtin ta ndryshoj dhe propozimin për përmbarrim ta hedhë poshtë si të pabazë.

Gjykata e Apelit, përmes gjyqtares individuale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditorja H.Sh. nga Prishtina, me datë 06.08.2020, ka ushtruar propozim për lejimin e përmbarrimit në bazë të titullit ekzekutiv - vendimit të Inspektoratit të Punës 01 nr. 33-34/2019-A të datës 20.02.2020, i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm nga data 20.05.2020, të paraparë më gjerësisht si në propozimin për përmbarrim.

Përmbarruesi Privat Bardh B. Tasholli duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditores me urdhrin P.nr.154/20, i datës 06.08.2020, e ka lejuar përmbarrimin në bazë të dokumentit përmbarrimor.

Kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarrimit debitori ka paraqitur prapësim me të cilin ka theksuar që dokumenti në bazë të cilit është lejuar përmbarrimi nuk mund të paraqitet si dokument ekzekutiv dhe i njëjti nuk është i përshtatshëm për përmbarrim ashtu siç kërkohet me nenin 27 par 1 të LPP –së, pasi në dispozitivin e tij nuk është cekur shuma e të hollave, ashtu siç ka kërkuar kreditorja e cila shumë do të përbënte obligim për debitorin, andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovet prapësimi i debitorit QKUK ashtu që Urdhri P.nr.154/20, i datës 06.08.2020, të ndryshohet dhe propozimi për përmbarrim të hedhet poshtë si i pa bazë.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditorja duke i propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit i pa bazuar, të vërtetohet urdhri përmbarrimor P.nr.154/20, i datës 06.08.2020 i përmbarruesit privat B B. T.

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditores ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar PPP.nr.879/22, të datës 07.02.2023 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës, me adresë në Prishtinë, i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarrimit P.nr.154/20, i datës 06.08.2020, i lejuar nga Përmbarruesi Privat B B. T, i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës ka konstatuar se propozimi për përmbarrim është bërë në bazë të Vendimit të Inspektoratit të Punës 01 nr. 33-34/2019-A të datës 20.02.2020, e që konform nenit 22 të LPP-së, paraqet dokument përmbarrues për përmbarrim dhe poashtu i përshtatshëm për përmbarrim nga se i përmban të gjitha elementet siç e parasheh dispozita e nenit 27 LPP-së, kreditorin, debitorin, objektin, mjetet e përmbarrimit, shumën dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK-së dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqë ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se vendimi i lëshuar nga Inspektorati i Punës 01 nr. 33-34/2019-A të datës 20.02.2020, në rastin konkret është dokument përmbarrues, kjo parashihet me nenin 22 paragrafi 1, pika 1.2 të LPP-së e cila dispozitë përcakton se: *“Dokument përmbarrues është edhe vendimi përmbarrues i dhënë në procedurë administrative”* dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarrimit sipas nenit 21 të LPP-së, i cili përcakton se: *“Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, e po ashtu i plotëson kushtet nga neni 24 paragrafi 3 të LPP-së me të cilin përcaktohet se: *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarrimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*, e po ashtu i përmban kërkesat nga neni 27 paragrafi 1 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, andaj edhe pretendimet e të autorizuarit të debitorës se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës përmbarrimore me rastin e refuzimit të prapësimit nuk qëndrojnë.

Gjykata e Apelit vlerëson se në këtë çështje juridike përmbarrimore, përmbarrimi është lejuar në bazë të Vendimit të Inspektoratit të Punës 01 nr. 33-34/2019-A të datës 20.02.2020, i cili i plotëson kushtet për përmbarrim dhe është i përshtatshëm për përmbarrim, bazuar në dispozitën e nenit 6.4 të Ligjit nr.2002/9 dhe 03/L-017 për Inspektoratin e Punës në Kosovës sipas së cilës dispozitë ankesa e ushtruar kundër vendimit të Inspektorit të Punës nuk e shtynë ekzekutimin e vendimit dhe dispozitën e nenit 144 par.1 pika 1.3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilën përcaktohet se : *“një akt bëhet i ekzekutueshëm me njoftimin e palës me aktin, kur sipas ligjit ankesa nuk ka efekt pezullues”*. Nga kjo rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, andaj kjo gjykatë vendosi që aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë ta vërtetojë dhe të refuzohet ankesa e debitorit si e pa bazuar.

Numri i lëndës: 2022:194100
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05626003

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitën e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK- së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1117/2023, me datën 23.04.2024

Gjyqtarja,
Halide Reka d.v